



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI I LËNDËS
Gjuhë e folur (1)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; ... leksione / 40 seminare
Viti / Semestri: Viti I , semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor “Gjuhë letërsi dhe qytetërim turk”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Studentët do të zhvillojnë aftësitë gjuhësore për t'iu përgjigjur situatave dhe strukturave gjuhësore të drejtpërdrejta me gojë.

Objektivat specifike lëndore:

1. Studentët do të zhvillojnë aftësitë për të kuptuar pikat kryesore, por edhe disa detaje thelbësore në një fjalim të zhvilluar që ka të bëjë me çështje të njohura në lidhje me punën, arsimin, argëtimin etj.
2. Studentët do të kenë aftësinë të kuptojnë, të përfshihen në biseda me folës natyrorë dhe të përgjigjen në fusha tematike si: njoftime ose informacione publike, reklama në programe televizive dhe radio, udhëzime nga punonjësit e shërbimeve të ndryshme, tregime dhe përshkrime të ngjarjeve, njerëzve, objekteve, hapësirave, ngjarje aktuale ose çështje të interesit personal/ profesional, arsimit, koha e lirë, udhëtimet, mallrat e konsumit, marrëdhëniet shoqërore

Rezultatet e pritshme:

1. Kuptojë pikat kryesore dhe disa detaje të rëndësishme në fjalime të strukturuar qartë që trajtojnë tema të njohura si puna, arsimi, koha e lirë dhe argëtimi.
2. Ndjekë dhe interpretojë informacionin nga burime publike të dëguara, si njoftime, reklama, udhëzime praktike apo lajme të thjeshta.
3. Marrë pjesë në biseda të përditshme me folës natyrorë, duke kuptuar rrjedhën e diskutimit dhe duke reaguar në mënyrë të përshtatshme në tema të njohura personale apo profesionale.
4. Përshkruajë ngjarje, vende, objekte dhe njerëz në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë në të folur.
5. Përdorë struktura gjuhësore të përshtatshme për të komunikuar në situata të zakonshme, si kërkimi i informacionit, dhënia e mendimit apo shprehja e ndjenjave.